

UDC 347.96/.99(497.115+497.7+496.5)

Egzona Osmanaj, PhD candidate¹⁸⁰

**PUSHTETI GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS,
MAQEDONISË DHE SHQIPËRISË
(Aspekte krahasimore)**

**СУДСКАТА ВЛАСТ ВО РЕПУБЛИКА КОСОВО,
МАКЕДОНИЈА И АЛБАНИЈА
(Компаративни аспекти)**

**JUDICIAL POWER IN REPUBLIC OF KOSOVO, MACEDONIA
AND ALBANIA
(Comparative Aspects)**

Abstract

During the evolving of principle for power delivery, judicial power has recognized a change in continuous grow of its role. Initially being under sanctions of the USA Constitution (1978) and afterwards with French Declaration, year 1789, this principle is still present in all Democratic Constitutions. Judicial power is one of the state functions which guaranties the supervision and protections of crucial standards which as set out by the lawmaking power.

Judicial acting aims to resolve the conflicts arisen between two citizens or caused between them and state authorities due to civil-judicial issues and penalize those who have violated the stipulated

¹⁸⁰ Phd. cand. South East European University. Tetovo. Republic of Macedonia. Lecturer. Faculty of Law. European College Dugajini. Peja. Republic of Kosovo. Email: egzona.osmanaj@evun.eu

standards by the law related to committed penal acts. It means that judicial power is exercised by the courts constituted by the law, constitution of courts, organizing and their competences, qualifications, the rights and obligations of the judges, which vary in different countries. The topic which I have treated has to deal with judicial power, treatment of this topic was mainly focused in comparative aspects, a part of the paper dealt with history, functioning, organizing and competences of the Courts in Republic of Kosovo, other part treated functioning, organizing and competences of the Courts in Republic of Macedonia and Albania in the final part are introduced the challenges and difficulties the said judicial systems are currently facing. This paper mainly has offered comparative information related to judicial system of the said countries.

Key word: court organizing structure, competences of the courts, qualifications, the rights and obligations of citizens.

Abstrakt

Në evolucionin e parimit të ndarjes së pushteteve, pushteti gjyqësor ka njohur një shndërrim të rritje të vazhdueshme të rolit të tij. I sanksionuar fillimisht në Kushtetutën e SHBA-se (1787) e pastaj në deklaratën franceze të vitit 1789 ky parim është i pranishëm sot në të gjitha kushtetutat demokratike. Pushteti gjyqësor është njeri prej funksioneve të shtetit që garanton mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e normave kryesore të vendosura nga pushteti ligjvënës. Veprimtaria gjyqësore ka si synim të zgjidhe konfliktet që lindin ndërmjet shtetasve ose ndërmjet tyre dhe organeve shtetërore për problemet juridiko-civile si dhe të ndëshkoje shkelësit e normave të parashikuara në ligj për veprat penale. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat të themeluara më ligj, themelimi i gjykatave, organizimi dhe kompetencat e tyre, kualifikimet të drejtat dhe detyrat e gjyqtarëve etj., dallohen nga shteti në shtet. Temën të cilën do ta shtjelloj në vijim ka të bëjë më pushtetin gjyqësor, trajtimi i kësaj teme do të përqendrohet kryesisht në aspekte krahasuese, një pjesë e punimit do të

trajtoj historikun, funksionimin, organizimin dhe kompetencat e gjykatave të Republikës së Kosovës, pjesa tjetër e punimit do të trajtoj funksionimin, organizimin dhe kompetencat e gjykatave të Republikës së Maqedonisë dhe Shqipërisë. Pra, ky punim do ofroje kryesisht informata krahasuese lidhur me sistemin gjyqësor të vendeve përkatëse.

Fjalë kyçe: struktura organizative e gjykatave, kompetencat e gjykatave kualifikimet, të drejtat dhe detyrat e gjyqtarëve.

Hyrje

Pushteti gjyqësor konsiderohet si pushteti i tretë shtetëror i cili ushtrohet nga gjykatat. Struktura organizative, kompetencat dhe funksionimi i gjykatave rregullohen më ligje të posaçme në çdo shtet. Kështu, edhe në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri ekzistojnë ligje të posaçme të cilat rregullojnë sistemin gjyqësor në tërësi. Duke u bazuar në ligjet në fuqi të shteteve të lartpërmendura punimi në vijim do ofroje të dhëna mbi funksionimin, organizimin e gjyqësisë në përgjithësi të këtyre vendeve duke u përpjekur kështu të bëjmë një analizë krahasimi, pra të sistemit gjyqësor të Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë, do shohim se sa përkojnë apo ndryshojnë njëra më tjetrën këto sisteme.

Parimet e Pushtetit Gjyqësor

Më kushtetute përcaktohen parimet bazë të funksionimit të gjyqësorit në tërësi, të cilat sigurojnë pavarësinë e gjyqësorit¹⁸¹, kështu:

a) *Pavarësia e gjykatave*, nënkupton pavarësinë e gjyqësisë nga legjislativi dhe ekzekutivi, ky parim konsiston në mosvarësinë e gjykatave nga parlamenti dhe qeveria, dhe në moushtrimin e kontrollit politik ndaj punës së tyre;

¹⁸¹ Arsim Bajrami. Draftimi i Kushtetutës. Manual për hartuesit e Kushtetutës dhe ligjeve. Prishtinë 200, f. 197.

b) *Depolitizimi i gjykatave*, ky parim nënkupton se funksioni i gjyqtarit është i papajtueshëm me asnjë funksion tjetër publik, profesion ose me anëtarësim në ndonjë parti politike.

c) *Zgjedhja e gjyqtarëve me afate të gjata*, nënkupton se gjyqtaret zgjidhen për periudha më të gjata kohore, duke u zgjedhur për periudha më të gjata kohore, gjyqtarët marrin garanci se do të jenë të pavarur nga ndryshimet politike, të cilat pasojnë pas çdo cikli të zgjedhjeve parlamentare.

ç) *Financimi i pavarur*, paraqet një garanci të funksionit të gjyqësisë së pavarur. Kjo nënkupton se, gjykatat duhen të financohen nga një buxhet i pavarur i tyre, i cili nuk do të jetë nën kontroll të përhershëm të qeverisë, por do të administrohet dhe menaxhohet nga vetë gjykata.

e) *Publiciteti*. Shqyrtimi pranë gjykatave dhe shqiptimi i aktgjykimit është publik. Publiciteti i gjykimit do të thotë, për veç palëve, në gjykim mund të marrin pjesë edhe persona të tretë të cilët nuk kanë interes konkret në procesin gjyqësor.

I. PUSHTETI GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

1. Një historik i shkurtër i sistemit gjyqësor i Republikës i Kosovës

Zhvillimin e sistemit gjyqësor në Kosove në përgjithësi mund ta ndajmë në tri periudha:

- zhvillimi i sistemit gjyqësor para vitit 1999 në kohën e ish-Jugosllavisë,
- zhvillimi i sistemit gjyqësor pas luftës së vitit 1999 d.m.th. pas shkëputjes nga Jugosllavia, dhe
- zhvillimi i sistemit gjyqësor pas shpalljes së pavarësisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Deri në vitin 1999, Kosova ka funksionuar në kuadër të Jugosllavisë, dhe natyrisht gjate kësaj kohe organizimi i sistemit gjyqësor, ashtu si edhe i organeve të tjera shtetërore të asaj kohe ka qene e

rregulluar sipas ligjeve të Jugosllavisë. Sistemi gjyqësor në Kosovë gjate kësaj periudhe ishte rënduar tej mase si pasoje e aplikimit të masave të dhunshme nga shteti i Serbisë e sidomos pas fillimit të represionit. Më ndryshimin e kushtetutës së Serbisë 1989, u bë rrënimi i plotë i Autonomisë së Kosovës, konkretisht këto ndryshime e pezulluan pushtetin e autoriteteve legjitime në Kosovë, u bë ndërprerja e punës së Kuvendit, Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, u morën kompetencat organeve gjyqësore dhe të sigurisë së pushtetit të Kosovës, të cilat u transferuan në Republikën e Serbisë. Me këto veprime, pasoi edhe marrja e kompetencave të administratës së judikaturës. Kështu, me vendimin e Kuvendit të Serbisë bëhet shkarkimi i gjyqtarëve shqiptarë, të cilët zëvendësohen me gjyqtarë serbë dhe në të njëjtën kohë bëhet ndërprerja e organizimit të provimit të judikaturës duke pamundësuar kuadro të reja që t'i nënshtrohen provimit të judikaturës dhe profesionalizmit në këtë fushë. Pasojat e gjithë kësaj, u reflektuan në ndërtimin e sistemit gjyqësor të pas luftës¹⁸². Më vendosjen e UNMIK-ut, u ndërmorën hapat fillestar për rindërtim të sistemit gjyqësor multietnik të bazuar në parimet demokratike. Kështu u themelua i ashtuquajtur i “sistemi emergjent gjyqësor” i cili u iniciua më 30 qershor 1999 më hapjen e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e ndjekur nga hapja e gjykatave edhe në disa vende të tjera në Kosovë, si në Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan. Deri në fund të vitit 1999 sistemi emergjent i drejtësisë arriti numrin 301 të gjyqtarëve.¹⁸³Në mars 2000, UNMIK-u themeloi Departamen-

¹⁸² Gjendja e menjëhershme e pasluftës në Kosovë, në fushën e gjyqësorit, rezultoi me një shkatërrim të gjerë në ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve, në infrastrukturë, teknologji dhe kuadro të kualifikuara, me shumë lëndë të pazgjidhura ndër vite, shkatërrim të dosjeve gjyqësore dhe dokumentacionit të rëndësishëm, problemet e sigurisë në rritje dhe me një gjyqësor ende jo funksional.

¹⁸³ Rithemelimi dhe Reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999 -201. Analizë kontesti. Maj 2011 Qendra Kosovare për Studime të barazisë. Shiko linkun më poshtë: http://www.qkss.org/repository/docs/RITHEMELIMI_DHE_REFORMIMI_I_SISTEMIT_T%C3%8B_DREJT%C3%8BSIS%C3%8B_N%C3%8B_KOSOV%C3%8B_105208.pdf

tin Administrativ të Drejtësisë, përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të çështjeve që kishin të bëjnë me sistemin gjyqësor. Kurse, në prill të vitit 2001 nga ana e UNMIK-ut u themelua edhe Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës (KGJK-ja). Detyra e KGJK-së ishte ti ftonte profesionistët e drejtësisë për të shërbyer në postet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë; shqyrtonte aplikacionet e tyre dhe jepte rekomandime për emërimin e tyre tek administrata e OKB-së në Kosovë. Në maj të vitit 2001 nën autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, UNMIK-u nxori Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Korniza Kushtetuese). Kjo kornizë parashihte krijimin e institucioneve të përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) që përbëheshin nga Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Kosovës, Qeveria, Gjykatat dhe organet tjera dhe institucionet e përcaktuara në kuadër të saj. Korniza Kushtetuese përcaktoi që sistemi gjyqësor të jetë i përbërë nga Gjykata Supreme, Gjykatat e Qarkut, Gjykatat Komunale dhe Gjykatat për Kundërvajtje. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, deri në fund të vitit 2003, në gjykatat e Kosovës ishin të emëruar dhe punonin gjithsej 316 gjyqtarë, përfshirë këtu edhe 14 gjyqtarë ndërkom-bëtarë, përfshirja e të cilëve u rregullua me Rregulloren e PSSP-së nr. 2000/6.

1.1 Sistemi gjyqësor pas shpalljes së pavarësisë

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, dhe me miratimin e Kushtetutës së Kosovës, organizimit të sistemit të drejtësisë i kushtohet një kapitull i veçantë (VII) ku nga neni 102-108 janë të sanksionuara parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, organizimi, juridiksioni, përfshirë këtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës si organ përgjegjës, i cili siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor, derisa rregullimin strukturor të gjykatave e ka lënë të vendoset me Ligj të veçantë¹⁸⁴. Në vitin 2010 është nxjerr Ligji për Gjykata Nr. 03/L-199 i cili përcakton sistemin e gjykatave të Republikës së Kosovës të përbërë nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit

¹⁸⁴ <http://www.gjykatasupreme-ks.org/?cid=1,24> (e vizituar më 04. 03. 2014 ora 14: 05).

dhe Gjykata Supreme. Pjesë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës janë edhe Gjyqtarët e EULEX-it, funksioni dhe kompetenca e të cilëve është e përcaktuar sipas Ligjit Nr. 03/L-053. Fillimi i zbatimit të Ligjit për Gjykatat, nisi në janar të vitit 2013.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE KOMPETENCAT E GJYKATAVE

Më Ligjin për Gjykatat në nenin 4 është përcaktuar së Sistemi i Gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga:
Degët themelohen brenda territorit të një Gjykate Themelore.




Tabela 1. Struktura organizative e Gjykatave të Kosovës.

2. 1 Gjykata themelore

Gjykatat themelore janë gjykata të shkallës së parë në territorin e Republikës së Kosovës. Ashtu si shihet edhe nga figura e mësipërm, ekzistojnë gjithsej shtatë (7) gjykata themelore, më degë të shpërndara në vende të ndryshme. “Në qoftë se në territorin e një komune nuk ekziston ndonjë degë, atëherë lëndët nga kjo komunë do të bien nën juridiksionin e selisë kryesore të Gjykatës Themelore”¹⁸⁵. “Nëse në territorin e një komunë nuk ekziston një degë e Gjykatës Themelore, atëherë kjo komunë mundet që, me vendim të Kuvendit Komunal, të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të themelojë një degë brenda territorit të saj ose që kjo të përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Themelore apo të degës së gjykatës më të afërt gjeografikisht”¹⁸⁶.

2. 1. 1 Organizimi i Brendshëm i Gjykatës Themelore

Në kuadër të gjykatës themelore ekzistojn këto departamente të paraqitura në tabelen në vijim:




Tabela 2. Organizimi i Brendshëm i Gjykatës Themelore.

¹⁸⁵ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 10 i këtij ligji.

¹⁸⁶ Po aty neni 11 i këtij ligji.

2. 1. 2 Departamenti për çështje Administrative i Gjykatës Themelore

Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj¹⁸⁷. Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.

2. 1. 3 Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore

Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore i gjykon veprat penale të parapara më Kodin penal të Kosovës si krime të rënda të tilla si: angazhimet në aktet terroriste, duke e mos e përjashtuar edhe përfshirjen në ndihmesën, mundësimin, organizimin apo mbështetjen ndaj terrorizmit apo grupeve terroriste; veprat penale kundër së drejtës ndërkombëtare që përfshin por nuk kufizohet në gjenocid, krimet kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës; trafikimi i emigrantëve; trafikimi i njerëzve; rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht; pengmarrja; etj.¹⁸⁸

2. 1. 4 Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore

Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencë e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore. Të gjitha lëndët e paraqitura pranë Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore do të gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionalë, përveç nëse me ligj nuk parashihet ndryshe¹⁸⁹.

¹⁸⁷ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 14, paragrafi (1).

¹⁸⁸ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 15.

¹⁸⁹ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 16.

2. 1. 5 Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore

Më Ligjin për gjykata të Kosovës është përcaktuar se Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore është kompetent për këto çështje: kontestet ndërmjet personave juridik vendor dhe të huaj lidhur me çështjet e tyre afariste; riorganizim, falimentim dhe shuarjen e personave juridik, nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe; kontestet lidhur me pengimin e posedimit, me përjashtim të pronës së paluajtshme, etj.¹⁹⁰

2. 2 Gjykata e Apelit

Gjykata e Apelit është gjykate e shkallës së dytë me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës. Selia e Gjykatës së Apelit është në Prishtinë. Gjykata e Apelit është kompetente të shqyrtojë:

- të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore;
- të vendosë në shkallë të tretë, sipas ankesës që është lejuar me ligj dhe për konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatave themelore;
- të vendos për konfliktin e juridiksionit ndërmjet Gjykatave Themelore;
- çështjet tjera të parapara me ligj¹⁹¹.

Njëjtë si Gjykata Themelore, ashtu edhe Gjykata e Apelit është e organizuar në pesë departamente: Departamenti i Përgjithshëm; Departamenti për Krime të Rënda; Departamenti për Çështje Ekonomike; Departamenti për Çështje Administrative; Departamenti për të Mitur.

¹⁹⁰ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 13. (Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe)

¹⁹¹ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 18.




Tabela 3. Struktura e Gjykatës së Apelit.

2. 3 Gjykata Supreme

Gjykata Supreme është autoriteti gjyqësor më i lartë në Kosovë dhe vendos si gjykatë e shkallës së tretë, për ankesat që lejohen me ligj dhe për mjetet juridike të jashtëzakonshme apo çështjet e tjera siç parashihet me ligj. Gjykata Supreme përfshin kolegjin e apelit të Agjencia Kosovare të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së cilës janë pjesë e Gjykatës Supreme¹⁹². Selia e Gjykatës Supreme është në Prishtinë.

2. 3. 1 Përbërja e Gjykatës Supreme

Më Kushtetutën e Kosovës në nenin 103 është përcaktuar se “të paktën pesëmbëdhjetë për qind (15%) e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë”¹⁹³. ”Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës e emëron dhe shkarkon Presidenti i Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e saj/tij”¹⁹⁴. Po ashtu, më Kushtetutën e Kosovës në nenin 103 është përcaktuar se edhe të paktën pesëmbëdhjetë për qind (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me juridiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë duhet të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

¹⁹² Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 21.

¹⁹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 103.

¹⁹⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 103 paragrafi 4.

2. 4. Emërimi i Gjyqtarëve

Sipas nenit 104 të Kushtetutës së Kosovës, Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Përbërja e gjykatave pasqyron përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Para dhënies së propozimit për emërim ose riemërim, Këshilli Gjyqësor i Kosovës këshillohet me gjykatën përkatëse.

Në Ligjin për Gjykata janë përcaktuar këto kualifikime të cilat duhet t'i posedojnë kandidatët për t'u emëruar si gjykatës, kështu:

- të jetë shtetas Kosovar
- të ketë më se paku njëzet e pesë (25) vite;
- të kenë diplomë të vlefshme universitare të juristit, të pranuar me ligjet e Kosovës;
- të ketë dhënë provimin e jurisprudencës;
- ta ketë dhënë provimin për gjyqtar në pajtim me Ligjin për Institutin Gjyqësor;
- të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral;
- të mos jetë i dënuar për vepër penale të përcaktuar me ligjin në fuqi;
- të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune juridike;
- të ketë kaluar me sukses procesin e vlerësimit në bazë të rregullave dhe të procedurave të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Përveç, kualifikimeve të lartpërmendura të njohura si kualifikime minimale, Ligji për Gjykatat ka përcaktuar edhe disa kualifikime të tjera, kështu “që të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, kandidati duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë si gjyqtarë në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore dhe së paku gjashtë (6) vite përvojë në fushën juridike duke përfshirë edhe përvojën në lëmin penal;”¹⁹⁵ “që të ushtrojë funksionin e gjyqtarit në Departamentin e Çështjeve Administrative ose Departamentin e Çështjeve Ekonomike të Gjykatës Themelore, kandidati duhet të ketë së paku gjashtë (6)

¹⁹⁵ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 26 paragrafi 2. 1.

vite përvojë në fushën juridike duke përfshirë edhe përvojën në çështjet administrative dhe ekonomike, respektivisht;”¹⁹⁶ “që të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit, kandidati duhet të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë si gjyqtar, ¹⁹⁷ “që të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme, kandidati duhet të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë si gjyqtar”. ¹⁹⁸

2.4.1 Mandati i gjyqtarëve

Më Kushtetutën e Kosovës në nenin 105, është parapare mandati fillestar trevjeçar për gjyqtarët. Në raste të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin. Kriteret dhe procedurat për riemërimin e një gjyqtari, përcaktohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe ato mund të dallojnë në shkallë nga kriteret e përdorura për shkarkimin e gjyqtarëve¹⁹⁹.

2.4.2 Shkarkimi i gjyqtarëve

Sipas Kushtetutës së RK neni 104 (paragrafi 4), Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave. Gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

2.5 Gjyqtarët porotë

Sipas Ligjit për Gjykata të Kosovës, për tu emëruar një kandidat si gjykatës porotë duhet plotësuar këto kualifikime:

- të jenë shtetas dhe banorë të Kosovës;
- të kenë më së paku njëzetepesë (25) vite;
- të kenë përfunduar me sukses trajnimin e kërkuar me ligj që të shërbej në kapacitetin e kërkuar;

¹⁹⁶ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 26 paragrafi 2. 2.

¹⁹⁷ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 26 paragrafi 2. 3.

¹⁹⁸ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 26 paragrafi 2. 4.

¹⁹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 105 paragrafi (1), (2).

- të kenë përmbushur kriteret e kërkuara nga rregulloret relevante të Këshillit Gjyqësor i Kosovës të mos jenë të dënuar për vepra penale me përjashtim të kundërvajtjeve;

- të kenë reputacion të lartë moral në shoqëri.

- Gjyqtarët porotë do të shpërblehen për shërbimet e tyre sipas një plani të kompensimi i cili përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.²⁰⁰

2.6 Detyrat e gjyqtarëve

Ligji për Gjykatat i Kosovës në nenin 34 detyrat e gjyqtarëve i ka përcaktuar kështu; Gjyqtarët veprojnë në mënyrë objektive, të paanshme dhe të pavarur. Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, gjyqtarët demonstrojnë disponueshmërinë, respektin për palët dhe dëshmitarëve si dhe vigjilencë në ruajtjen e shkallës më të lartë të kompetencës. Gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore, gjyqtarët mbrojnë konfidencialitetin e çdo informacioni jopublik. Gjyqtarët nuk komentojnë në media përmbajtjen, provat dhe vendimet e cilësdo lëndë. Gjyqtarët nuk përfshihen në çfarëdo komunikimi ex parte me askënd lidhur me lëndët. Gjyqtarët duhet të përfshihen në arsimimin e vazhdueshëm ligjor në përputhje me rregulloret e shpallura nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.²⁰¹

2.7 Paga dhe kompensimi gjyqësor

Sipas Ligjit për Gjykata të Kosovës gjykatësit do të pranojnë pagat si në vijim:

²⁰⁰ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 28.

²⁰¹ Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 34 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5. (Kurse në nenin 35 parashihen ndalesat mbi sjelljen e gjyqtarëve Gjyqtarët nuk kryejnë asnjë detyrë apo shërbim që mundet apo mund të perceptohet si ndërhyrje me pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre apo që përndryshe nuk është në përputhje me detyrat e një gjyqtari apo dispozite të Kodit të Mirësjelljes për Gjyqtarë. Gjyqtarët nuk janë pjesëtarë të një partie politike, lëvizjeje apo çfarëdo organizate tjetër politike e as të marrë pjesë në çfarëdo lloj veprimtarie politike. Gjyqtarët nuk do të kërkojnë e as nuk do mbajnë asnjë lloj të zyrës politike).

- Kryetari i Gjykatës Supreme do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

- të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme do të pranojnë një pagë ekuivalente me atë të një ministri në Qeveri.

- Kryetari i Gjykatës së Apelit do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës.

- të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit do të pranojnë një pagë ekuivalente prej nëntëdhjetë (90) % të Kryetarit të Gjykatës së Apelit.

- Kryetari i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit.

- gjyqtari mbikëqyrës i një dege të Gjykatës themelore do të pranojë një pagë ekuivalente me nëntëdhjetepesë (95) % të Kryetarit të Gjykatës Themelore.

- çdo gjyqtar i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë bazë jo më pak se shtatëdhjetë (70)% të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të shpallë një plan për kompensime shtesë të cilat njohin përgjegjësinë unike të gjyqtarëve të cilët shërbejnë në departamentet për krimet e rënda, Çështjet Ekonomike apo Administrative; por shumica e pagës bazë dhe kompensimeve shtesë në asnjë rast nuk do të tejkalojë nëntëdhjetë (90) % të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore²⁰².

III. PUSHTETI GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat në Republikën e Maqedonisë, në bazë të Kushtetutës, të ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.

Sistemi Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë përbëhet nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit Gjykata Administrative dhe

²⁰² Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës. Nr. 03/L-199. Neni 29.

Gjykata Supreme²⁰³. Organizimi i gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë është unitar. Gjykatat e jashtëzakonshme janë të ndaluara.




Tabela 4. Struktura Organizative e Gjykatave të Maqedonisë

3.1. Gjykata Themelore

Gjykatat themelore janë kompetente të vendosin në shkallë të parë për çështje në kompetencë gjyqësore, për veç çështjeve të cilat me ligj i janë lënë një gjykate tjetër²⁰⁴. Gjykatat Themelore janë kompetente për gjykimin në shkallë të parë të procedurës penale, për delikte ekonomike, pronësore dhe kontestet juridiko-civile e kështu me radhë. Gjykatat themelore janë kompetente të vendosin në shkallë të parë edhe për çështjet jashtëprocedurale, ekzekutimin dhe sigurimin edhe për vërtetimin e tapive dhe intabulacionet, në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar kompetenca e organit ose institucionit tjetër.

²⁰³ Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë, neni 22.

²⁰⁴ Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë, neni 23.

3.2. Gjykata e Apelit

Gjykatat e Apelit janë Gjykata te shkallës së dytë të themeluara për territoret e më shumë gjykatave themelore. Gjykatat e Apelit janë kompetente:

- të vendosin mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave themelore,
- të vendosin për mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet gjykatave themelore në territorin e tyre dhe
- të kryejnë veprime të tjera të përcaktuara me ligj²⁰⁵.

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë katër (4) Gjykata Apeli më seli në Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip.

3.3. Gjykata Administrative

Më Ligjin për Gjykatat të RM, në nenin 34 janë përcaktuar këto kompetenca të Gjykatës Administrative:

- o për ligjshmërinë e akteve të caktuara të nxjerra ne procedurën zgjedhore dhe të akteve të caktuara për zgjedhje, emërim dhe shkarkime të bartësve të funksioneve publike, nëse ajo është përcaktuar me ligj, si dhe për aktet për emërim, caktim dhe shkarkim të nëpunësve udhëheqës shtetërore, nëse më ndryshe nuk është përcaktuar më ligj,

- o për ligjshmërinë e akteve të organeve shtetërore, të Qeverise dhe të bartësve të autorizimeve publike, të nxjerra në forme të dispozitës nëse ato i rregullojnë marrëdhëniet e caktuara,

- o për kontest qe do të dale nga zbatimi dhe realizimi i dispozitave të marrëveshjeve të koncesioneve, marrëveshjeve për furnizimet publike që janë më interes publik, dhe për secilën marrëveshje në të cilën njëra nga palët është organ shtetëror, organizatë më autorizime publike, ndërmarrje publike, komunat dhe Qyteti i Shkupit te lidhur me interes publik ose për shkak kryerjes së shërbimit publik.

- o kundër akteve të caktuara të organeve të administratës shtetërore, Qeveria, organet tjera shtetërore, komunat dhe Qyteti i

²⁰⁵ Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë, neni 33.

Shkupit, organizatat e përcaktuara me ligj dhe te personave juridike dhe personave tjerë ne kryerjen e autorizimeve publike (bartës te autorizimeve publike), kur për vendosje në shkalle të dytë kundër aktit të tillë, nuk është siguruar ndonjë mbrojtje tjetër juridike dhe vendos për ndeshjen e kompetencave midis organeve te Republikës, midis komunave dhe Qytetit të Shkupit, midis komunave të Qytetit të Shkupit edhe për kontestet e krijuara për ndeshje të kompetencave midis komunave dhe Qytetit te Shkupit dhe bartësve të autorizimeve publike, nëse ajo është përcaktuar me ligj, nëse më Kushtetute ose me ligje nuk është përcaktuar tjetër mbrojtje gjyqësore.

3.3.1.. Gjykata e Lartë Administrative

Më Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykata, (Nr. 35/2008), themelohet Gjykata e Lartë Administrative, më seli në Shkup që ushtron pushtetin gjyqësor në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë²⁰⁶.

Gjykata e Lartë Administrative është kompetente: të vendosë për ankesat kundër vendimeve të Gjykatës Administrative; “Të vendosë për konfliktin e kompetencave ndërmjet organeve të Republikës, ndërmjet komunave dhe Qytetit të Shkupit, ndërmjet komunave të Qytetit të Shkupit dhe për kontestet e ndodhura për konfliktin e kompetencave ndërmjet komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe bartësve të autorizimeve publike, nëse kjo është paraparë me ligj, nëse me Kushtetutë ose ligje nuk është paraparë mbrojtje më ndryshe gjyqësore dhe të kryejë punë të tjera të përcaktuar më ligj²⁰⁷”.

3.4. Gjykata Supreme

Gjykata Supreme është Gjykata më e Lartë në territorin e Republikës së Maqedonisë, selia e saj ndodhet në Shkup, e cila ushtron pushtetin gjyqësor në gjithë territorin e Maqedonisë. ***Gjykata e Supreme është kompetente të vendosë:***

²⁰⁶ Neni 25 paragrafi(1), (2) i këtij ligji.

²⁰⁷ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykata të Maqedonisë, Neni 26. Nr. 35/2008.

- në shkallë të dytë kundër vendimeve të këshillave të saja kur kjo është e përcaktuar me ligj;

- në shkallë të tretë dhe përfundimisht mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit dhe kundër vendimeve të këshillave të saja të sjella në shkallë të dytë kur kjo është e përcaktuar me ligj;

- në shkallë të parë dhe shkallë të dytë në kontestet administrative kur kjo është përcaktuar me ligj dhe vendos për vendimet përfundimtare të sjella në procedurën e kundërvajtjeve;

- vendos për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të saja kur kjo është përcaktuar me ligj;

- vendos për mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet gjykatave themelore të territoreve të ndryshme të gjykatave të apelit, ndërmjet gjykatave të apelit dhe vendos për delegimin e kompetencës vendore te këto gjykata²⁰⁸.

Gjykata e lartë për mjetet juridike vendos në këshill të përbërë nga 5 gjyqtarë, në qoftë se me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

3.4.1. Emërimi i gjyqtarëve

Gjyqtaret dhe kryetaret e gjykatave i zgjedh dhe i shkarkon Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në kushte dhe në procedure të përcaktuar me ligj.

Sipas Ligjit për Gjykata të Republikës së Maqedonisë²⁰⁹ gjyqtar mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- a) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- b) në mënyrë aktive ta zotërojë gjuhën maqedonase,
- c) të jetë i aftë për pune dhe të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- ç) të ketë diplomë universitare për jurist të diplomuar në

²⁰⁸ Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë, Neni 35. (11 maj 2006)

²⁰⁹ Neni 45 i këtij ligji.

Republikën e Maqedonisë ose diplome të nostrifikuar nga fakulteti i huaj juridik dhe

d) të ketë të dhënë provimin e judikaturës në Republikën e Maqedonisë.

Përveç kushteve të lartpërmendura, Ligji për Gjykata i RM²¹⁰ ka parapare edhe kushtet e veçanta për zgjedhjen e gjyqtarëve kësisoj:

a) për gjyqtar në Gjykatën themelore mund të zgjidhet personi i cili e ka mbaruar aftësimin në Akademinë për aftësim të gjyqtarëve dhe prokurorëve publike,

b) për gjyqtar te Gjykatës se apelit mund te zgjidhet personi i cili ka përvojë pune prej se paku pesë vjet stazh gjyqtari më rezultate të dëshmuara në pune ose tetë vjet përvojë pune në punë juridike pas dhënies së provimit të judikaturës,

c) për gjyqtar në Gjykatën administrative mund të zgjidhet personi i cili ka përvojë pune prej se paku pese vjet ne gjykate me rezultate të dëshmuara në punë, ose se paku tetë vjet stazh pas dhënies se provimit të judikaturës, ne çështje administrative, ose është profesor universitar nga lëmi i drejtësisë më titull shkencor doktor i shkencave juridike dhe

ç) për gjyqtar të Gjykatës supreme te Republikës së Maqedonisë, mund të zgjidhet personi i cili ka përvojë pune prej se paku tetë vjet stazh gjyqtari më rezultate të dëshmuara në pune ose 12 vjet përvojë pune më rezultate dëshmuase në çështje juridike pas dhënies se provimit të judikaturës.

Kryetar i gjykatës zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë, në kushte, në procedurë dhe në mënyrë siç bëhet zgjedhja e gjyqtarit në gjykatën adekuate. Kryetari i gjykatës zgjidhet me mandat katërvjeçar, me mundësi që përsëri të zgjidhet në të njëjtin funksion edhe katër vjet²¹¹. Zgjedhjen, respektivisht shkarkimin e gjyqtareve dhe kryetarëve të gjykatave, Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë e boton ne "Gazetën zyrtare të Republikës

²¹⁰ Neni 46 i këtij ligji.

²¹¹ Ligji për Gjykata i Republikës së Maqedonisë, neni 47.

së Maqedonisë" në afat prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjes së bërë, respektivisht shkarkimit. Gjyqtarët porotë i zgjedh dhe i shkarkon Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në kushte dhe në procedure të përcaktuar me ligj²¹². Për gjyqtar porotë mund të zgjidhet shtetasi i moshës madhore i Republikës së Maqedonisë me shkolle të kryer minimale të mesme, i cili aktivisht e zotëron gjuhën maqedonase, gëzon autoritet për kryerjen e funksionit dhe i cili nuk është më i vjetër se 60 vjet. Gjyqtari porotë për gjykimin e të miturve zgjidhet nga radhët e personave më përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjve²¹³. Gjyqtari porotë zgjidhet për kohe katërvjeçare me mundësi rizgjedhjeje²¹⁴.

3.5. Pushimi i funksionit gjyqtar

Ligji për Gjykata të RM në nenin 72 ka përcaktuar në rastet në të cilat gjyqtarit i pushon funksioni gjyqtar, kështu:

- o nëse: - atë vet e kërkon,
- o përgjithmonë e humb aftësinë për kryerjen e funksionit të gjyqtarit, që e përcakton Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë;
- o i plotëson kushtet për pensionim në bazë të moshës;
- o zgjidhet ose emërohet në funksion tjetër publik,
- o përveç kur funksioni i gjyqtarit pushon nën kushte të përcaktuara me ligj dhe
- o është i dënuar me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale në dënim më burg pa kusht prej se paku gjashtë muajve.

3.5.1 Shkarkimi i gjyqtarit

Sipas Ligjit për Gjykata të RM, gjyqtari shkarkohet nga funksioni i gjyqtarit:

²¹² Neni 42 i këtij ligji.

²¹³ Neni 48 i këtij ligji.

²¹⁴ Neni 49 i këtij ligji.

- për shkak të shkeljes më të rënde disiplinore që e bënë të padenjshëm për kryerjen e funksionit të gjyqtarit të përcaktuar me ligj dhe
- për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

3.5.2 Pagat e gjyqtarëve

Pagat e gjyqtarëve në RM janë të rregulluar me Ligjin mbi pagat e gjyqtarëve. Kështu, sipas këtij ligji pagat janë të llogaritura sipas dy parametrave: pagës mesatare neto në vend gjatë vitit të kaluar; koeficientit i cili varet nga një sërë faktorësh që ndikojnë në kompleksitetin e detyrave të gjykatësit dhe në ngarkesën e punës së tij. Koeficienti lëviz midis 2, 8 dhe 3, 7 në varësi të: llojit të gjykatës në të cilën gjykatësi punon (Gjykatës themelore, Gjykatës themelore me kompetencë të zgjeruar, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Administrative, Gjykatës Supreme); sektorit të specializuar gjyqësor (sektorit penal, civil, kundërvajtës), detyrave e brendshme brenda gjykatës (kryetar: i gjykatës, i një departamenti, sektori, këshilli); përvojës profesionale; performancës së gjyqtarit. Pagat e llogarit në bazë të Ligjit për pagat e gjykatësve nuk mund të zvogëlohen me ligje të tjera ose me vendime nga organet e tjera shtetërore²¹⁵.

IV. PUSHTETI GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Sistemi Gjyqësor i Republikës i Shqipërisë përbëhet nga Gjykata e shkallës së parë, e cila ndryshe emërtohet edhe si gjykata themelore apo gjykata e faktit, Gjykata e Apelit, Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë. Sistemi ushtarak i drejtësisë është i përfshirë në sistemin e drejtësisë penale. ”²¹⁶ Sistemi Gjyqësor i Shqipërisë ka mbi 300 gjyqtarë të cilët janë të shpërndarë në 29 Gjykata Fakti, 6

²¹⁵ Përveç kësaj, gjykatësit kanë të drejtë për përfitime plotësuese lidhur me udhëtimet profesionale dhe mbështetje në shumën e dy rrogave mesatare.

²¹⁶ http://www.gjykata.gov.al/portal_main/CourtsExplanation.aspx (e vizituar më 05. 03. 2014 ora 10: 17)

Gjykata Apeli, 1 Gjykatë Ushtarake Apeli dhe në Gjykatën e Lartë. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ndalon krijimin e Gjykatave të Jashtëzakonshme në nenin 135 pika 2 e saj thuhet: "Kuvendi mund të krijojë me ligj Gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast Gjykata të Jashtëzakonshme".




Tabela 5. Struktura e Gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

4.1. Gjykata e shkallës së parë

Ashtu, siç shihet edhe nga tabela e mësipërm në Shqipëri pra, gjykata të shkallës së parë janë gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykatat e krimeve të rënda. Gjykatat e rretheve gjyqësore organizohen dhe funksionojnë në rrethe gjyqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjykatat për krimet e rënda organizohen dhe funksionojnë në një ose më shumë rrethe gjyqësore. Kompetencat tokësore të gjykatave dhe qendra e ushtrimit të veprimtarisë për secilën prej tyre caktohen me dekret nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë bën propozimet pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë²¹⁷. Çështjet penale, në shkallën e parë, gjykohen nga një panel i përbërë prej 3 gjyqtarësh në rastet kur objekt i gjykimit janë veprat penale dhe nga një gjyqtar në rastet kur gjykohen kundërvajtje penale. Një gjyqtar mund të gjykojë i vetëm vepra penale, për të cilat parashikohet një dënim për jo më shumë se 5 vjet, kurse një panel i përbërë nga 3 gjyqtarë gjykon vepra penale më serioze.

²¹⁷ Neni 6, paragrafi (1), (2), (3), (4).

Çështjet Civile në shkallën e parë (këtu përfshihen edhe çështjet administrative dhe ato tregtare), shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm ose nga një panel prej tre gjyqtarësh. Kjo varet nga vlera e objektit të padisë dhe nga lloji i çështjes në shqyrtim. Në përbërje të Gjykatave të rretheve gjyqësore krijohen seksione të veçanta për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, tregtare dhe familjare.

4.2. Gjykata e Apelit

Gjykate e shkallës së dytë në Republikën e Shqipërisë është Gjykata e Apelit në të cilën shqyrtohen të gjitha çështjet e gjykuara nga gjykatat e shkallës së parë, të cilat ankimohen nga palët ndergjyqëse. Megjithatë Gjykata e Lartë ushtron edhe juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese²¹⁸. Në Shqipëri ekzistojnë 6 Gjykata Apeli dhe 1 Gjykatë Apeli ushtarake, kjo e fundit me juridiksion të plotë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjykatat e Apelit përbëhen nga 47 gjyqtarë dhe 97 anëtarë të stafit administrativ.

Juridiksioni territorial i Gjykatave të Apelit caktohet me dekret të Presidentit të Republikës mbi një propozim të Ministrit të Drejtësisë dhe pasi të jetë marrë paraprakisht mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjykatat e Apelit kanë si kompetencë të shqyrtojnë dhe të vendosin në lidhje me pretendimet kundër vendimeve të Gjykatave të shkallës së parë. Ato i marrin vendimet në trup gjykues të përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë. Gjykata Ushtarake e Apelit e cila, siç u tha më lart, është një e vetme për të gjithë territorin e Republikës, gjykon në shkallë të dytë çështjet penale të gjykuara nga kolegjet penale ushtarake të shkallës së parë. Gjykata Ushtarake e Apelit gjykon gjithnjë me trup gjykues të përbërë nga 3 anëtarë²¹⁹.

²¹⁸ <http://www.shtetiweb.org/category/institucionet-publike/pushteti-gjyqesor> (e vizituar më 03. 03. 2014 ora 14: 12)

²¹⁹ http://www.gjykata.gov.al/portal_main/SupremeCourt_explanation.aspx (e vizituar më 05. 03. 2014 ora 13: 32).

4.3. Gjykata e Lartë

Gjykata e Lartë është autoriteti më i lartë gjyqësor, i cili ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuza penale kundër:

- Presidentit të Republikës,
- Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave,
- Deputetëve,
- Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë
- Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata e Lartë e ka selinë në Tiranë dhe përbëhet nga 17 gjyqtarë të cilët emërohen nga rradhët e gjyqtarëve me vjetërsi jo më pak se 10 vjet, ose nga rradhët e juristëve të shquar, që e kanë ushtruar këtë profesion jo më pak se 15 vjet.²²⁰ Gjyqtarë mund të jenë vetëm shtetasit shqiptarë. Gjykatësit e Gjykatës së lart emërohen nga presidenti i republikës pasi të merret pelqimi nga Kuvendi. Kryetari i Gjykatës së Lartë zgjidhet njëri nga anëtarët e saj i cili emërohet si i tillë nga Presidenti i Republikës, pasi të jetë marrë më parë pelqimi i Kuvendit. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë fillon me hyrjen në fuqi të dekretit të Presidentit për emërimin e tij. Edhe mandati i Kryetarit të Gjykatës së Lartë llogaritet brenda mandatit të gjyqtarit të kësaj gjykate²²¹. Gjyqtarët dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi, por koha prej 9 vjetësh nuk mund të kufizohet. Qëndrimi në detyrë lidhet edhe me moshën e tyre. Pra, ata mund të qëndrojnë në detyrë deri në moshën 65 vjeç.

4.4. Emërimi i gjyqtarëve

Sipas Ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor të RSH²²², për tu emëruar një kandidat si gjyqtar duhet t'i plotësojë këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë me arsim të lartë juridik;

²²⁰ Projektligji

²²¹ http://www.gjykata.gov.al/portal_main/SupremeCourt_explanation.aspx (e vizituar më 05. 02. 2014)

²²² Neni 11 i këtij ligji.

c) të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
 ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) të ketë cilësi të larta morale dhe aftësi profesionale.

Gjyqtari i gjykatës për krimet e rënda emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, këtu kërkohen edhe disa kushte të tjera përveç atyre minimaleve:

a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në gjykatat e shkallës së parë;

b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;

c) të jetë vlerësuar "Shumë mirë" për aftësi profesionale dy herët e fundit;

ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi²²³.

Gjithashtu, Ligji për gjykatat i RSH ka përcaktuar së gjyqtari i gjykatës së apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi:

a) të ketë punuar jo më pak se 7 vjet në gjykatat e shkallës së parë;

b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;

c) të jetë vlerësuar "Shumë mirë" për aftësi profesionale dy herët e fundit;

ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi²²⁴.

4.5 Pagesat e Gjykatësve

Paga bazë e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të

²²³ Neni 12 paragrafi 2, (pika a, b, c, ç) i këtij ligji.

²²⁴ Neni 12 paragrafi 3 i këtij ligji.

Gjykatës së Lartë. Paga bazë e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Paga bazë e kryetarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 70 % të pagesës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë²²⁵.

V. PËRFUNDIMI

Ngjashmëritë dhe dallimet në organizimin e veprimtarisë gjyqësore në RM, RK dhe RSH, në përgjithësi konsistojnë në atë se:

I. Në Republikën e Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë në shkallë të parë pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykatat themelore, në Kosovë ekzistojnë shtatë (7) gjykata themelore të cilat janë të organizuara në pesë departamente, departamenti për Krimet e Rënda që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore; departamenti i Përgjithshëm që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore, si dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore; departamenti për të Mitur, që vepron në kuadër të gjykatave themelore, si dhe departamenti për Çështjet Ekonomike dhe departamenti për Çështjet Administrative, të cilat veprojnë vetëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

II. Në Kosovë nuk ekziston Gjykata Administrative e veçantë, por çështjet administrative gjykohen nga departamenti për çështje administrative që vepron në kuadër të gjykatës themelore dhe gjykatës së apelit në Prishtinë për gjithë territorin e Kosovës. Ndryshe, nga Shqipëria dhe Maqedonia të cilat kanë të themeluara gjykatat administrative të cilat janë të organizuara pak a shumë në mënyrë të njëjtë.

III. Në shkallë të dytë si në RM, RK dhe RSH gjykojnë gjykatat e Apelit, në Shqipëri ekzistojnë 6 (gjashtë) Gjykata Apeli, në Maqedoni ekzistojnë katër (4) gjykata Apeli, kurse në Kosovë ekziston vetëm një Gjykatë Apeli më seli në Prishtinë për gjithë territorin e Kosovës.

²²⁵ Po aty, neni 27 i këtij ligji.

IV. Në Kosovë emërimin e gjyqtarëve e bënë Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për një mandate fillestar trevjeçar, po ashtu edhe në Shqipëri emërimin e gjyqtarëve e bënë Presidenti më propozimin e Këshillit Drejtues, në Maqedoni emërimin e gjyqtarëve e bënë Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë gjyqtarët zgjidhen pa kufizimin e zgjatjes së mandatit.

V. Për t'u zgjedhur gjyqtar në Gjykatën e Apelit, në Shqipëri ndër të tjera kërkohet kandidati të ketë punuar jo më pak se 7 vjet në gjykatat e shkallës së parë, në Kosovë kërkohet të ketë 10 vite përvoje pune si gjyqtar, në Maqedoni kërkohet kandidati të ketë së paku 5 vite përvoje në lëndët gjyqësore.

VI. Në Kosovë që të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme, kandidati duhet të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë si gjyqtar, për gjyqtar në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë mund të zgjidhet edhe profesor universitar ordinar dhe inordinar që ka dhënë mësim më shumë se dhjetë vjet lëndë juridike lidhur më praktikën gjyqësore.

VI. REKOMANDIME

I. Në Kosovë do duhej, departamenti për çështje ekonomike dhe administrative të ekzistojë edhe në gjykatat e tjera themelore të Kosovës, jo vetëm në atë Prishtinës për tërë territorin e Kosovës që ekziston aktualisht;

II. Do të ishte e nevojshme të themelohej edhe gjykata e veçantë për gjykimin e çështjeve administrative, ashtu siç ekziston në Maqedoni dhe Shqipëri.

III. Në Kosovë, Gjykata e Apelit pos Prishtinës duhet të ekzistojë të paktën edhe në një vend tjetër të Kosovës.

- Literatura

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
3. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.
4. Ligji për Gjykatat i Kosovës Nr. 03/L-199. 22 korrik 2010.
5. Ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë Nr. 9877, datë 18. 2. 2008 (Ndryshuar me Vendimin nr. 20/2009 te Gjykatës Kushtetuese).
6. Ligji për Gjykatat i Maqedonisë Nr. 58/2006 dhe 35/2008.

- Burime nga interneti

1. http://www.gjykata.gov.al/portal_main/CourtsExplanation.aspx (e vizituar më 05. 03. 2014 ora 10: 17).
2. [http://www.gjykatasupreme-ks.org/?cid=1, 24](http://www.gjykatasupreme-ks.org/?cid=1,24) (e vizituar më 04.03.2014 ora 14: 05).
3. <http://www.shtetiweb.org/category/institucionet-publike/pushteti-gjyqesor> (e vizituar më 03.03.2014 ora 14:12)
4. http://www.gjykata.gov.al/portal_main/SupremeCourtExplanation.aspx (e vizituar më 05.03.2014 ora 13:32).
5. http://www.gjykata.gov.al/portal_main/SupremeCourtExplanation.aspx (e vizituar më 05. 02. 2014).

- Raporte

1. Rithemelimi dhe Reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999 -201. Analizë kontesti. Maj 2011 Qendra Kosovare për Studime të barazisë.